



Bazuar në nenin 36, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, dhe nenin 65, paragrafët 1 dhe 2 të Ligjit Nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 77/16 gusht 2010) të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 05/L -150 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 10 / 03 prill 2017), neni 94 paragrafi 4 dhe neni 114 i Ligjit nr. 04/L-093 për Bankat Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës S / Nr. 11/11 maj 2012, Prishtinë) nenin 8, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, dhe paragrafi 2, nënparagrafi 2.3, të Ligjit Nr.04/L-155 për Sistemin e Pagesave (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.12/03 Maj 2013), si dhe nenin 136 të Ligjit Nr. 10/L-026 për Shërbime të Pagesave (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 10 / 14 maj 2026), Bordi i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 29 qershor 2026, miratoi këtë:

RREGULLORE

PËR QASJEN E OFRUESËVE TË SHËRBIMEVE TË PAGESAVE JO-BANKA NË SISTEMET E PAGESAVE

Neni 1

Qëllimi dhe fushëveprimi

1. Qëllimi i kësaj Rregulloreje është të përcaktojë kushtet, kriteret, kërkesat dhe procedurat për aprovimin e qasjes së Ofruesve të Shërbimeve të Pagesave jo-banka (nga këtu e tutje: OSHP jo banka) në sistemet e pagesave ndërbankare që operojnë dhe mbikëqyren nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (nga këtu BQK).
2. Kualifikimi i OSHP-ve jo-banka për qasje në sistemet e pagesave ndërbankare të operuara nga BQK ka për qëllim rritjen e efikasitetit, konkurrencës dhe funksionimit të sektorit të pagesave, duke përfshirë, por pa u kufizuar vetëm në lehtësimin e ofrimit të pagesave në të gjithë territorin e Republikës së Kosovës.
3. Kjo Rregullore zbatohet nga të gjithë ofruesit e shërbimeve të pagesave.

Neni 2

Përkufizimet

1. Të gjitha termat e përfshira në këtë Rregullore kanë të njëjtin kuptim me termat e përcaktuara në Ligjin për Sistemin e Pagesave, Ligjin për Shërbimet e Pagesave dhe/ose të përcaktuara më poshtë për qëllime të kësaj Rregullore:
 - 1.1. **Institucion pagese** – nënkupton një person juridik që i është dhënë autorizimi në pajtim me Nenin 14 të Ligjit për Shërbime të Pagesave për ofrimin dhe ekzekutimin e shërbimeve të pagesave në Kosovë;

- 1.2. **Institucionet e parasë elektronike** – nënkupton një person juridik të cilit i është dhënë autorizimi nga BQK për emetimin e parave elektronike;
- 1.3. **Llogari për mbrojtën e fondeve** – nënkupton një llogari e veçantë në një institucion krediti ose në BQK, nga një ofrues i shërbimeve të pagesave jo-banka që përdoret për të ndarë dhe mbrojtur fondet e klientëve të tyre nga fondet e veta;
- 1.4. **Ofrues i shërbimit të pagesave** – nënkupton një person fizik ose juridik që ofron shërbime pagesash (p.sh., emetim, blerje, autorizim i transaksioneve, vërtetim i përdoruesve fundorë) që mundëson transferimin e vlerës midis përdoruesve fundorë. (Banka, Institucione të Parasë Elektronike, Institucione Pagesash, Institucione Postare, BQK, Autoritete Publike Qendrore);
- 1.5. **Ofrues i shërbimit të pagesave jo-bankë (OSHP jo-bankë)** – nënkupton një institucion financiar jo-bankar i licencuar dhe i autorizuar nga BQK për të ofruar shërbime të pagesave dhe/apo shërbime të parave elektronike në përputhje me Ligjin për Shërbimet e Pagesave. Ky përkufizim përfshin institucionet e pagesave dhe institucionet e parasë elektronike;
- 1.6. **Sistem i ndërlidhur** – nënkupton një sistem përmes të cilit realizohet këmbimi dhe/ose kliringu i pagesave apo letrave me vlerë, ndërsa shlyerja përfundimtare e obligimeve monetare që rrjedhin nga këto transaksione kryhet në një sistem tjetër, zakonisht në një sistem RTGS;
- 1.7. **KIPS** (Kosovo Interbank Payment System) – është sistem i automatizuar për procesimin e transaksioneve të pagesave ndërbankare në Republikën e Kosovës;
- 1.8. **TIPS Clone** – sistem i pagesave të shpejta që i mundëson ofruesve të shërbimeve të pagesave të ofrojnë transferime fondesh për klientët e tyre në kohë reale dhe gjatë gjithë ditës, çdo ditë të vitit;
- 1.9. **RTGS** – nënkupton sistemin e shlyerjeve bruto në kohë reale të pagesave me vlera të mëdha dhe urgjente i operuar nga BQK, pjesë përbërëse e KIPS-it;
- 1.10. **ACH** – nënkupton sistemin automatik të kliringut ndërbankar për vlera të vogla të realizuar sipas sesioneve në baza neto, i operuar nga BQK, pjesë përbërëse e KIPS-it;
- 1.11. **Shuma maksimale e mbajtjes** – i referohet kufirit më të lartë të fondeve që një OSHP jo-banke mund të mbajë në llogarinë e hapur në BQK apo në sistemet e pagesave që operohen ose mbikëqyrën nga BQK;
- 1.12. **DSP** – Departamenti i Sistemeve të Pagesave në BQK;
- 1.13. **Fundi i ditës së punës** – nënkupton kohën e ndërprerjes, siç përcaktohet në rregullat e sistemit të pagesave të operuar nga BQK për shlyerjen e urdhrave pagesave për atë ditë pune;
- 1.14. **Operatori i Sistemit të Pagesave** – nënkupton Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, si entiteti që është përgjegjës për operimin dhe/apo administrimin e një sistemi të pagesave, kliringut apo shlyerjes së letrave me vlerë / apo një operator tjetër i licencuar dhe mbikëqyrur nga BQK;
- 1.15. **Sistem i pagesave ose sistem** - sistemi ku dy ose më tepër pjesëmarrës bashkëpunojnë në mundësimin e kryerjes së pagesave apo lehtësimin e qarkullimit të parasë, dhe përfshin çdo marrëveshje dhe/apo procedurë për procesimin, shkëmbimin, kliringut, strukturimin dhe/apo shlyerjen e transaksioneve të pagesave. Ky term përfshin këmbimet në instrumentet e pagesave.

1.16. Shërbime Pagesash - do të thotë çdo një nga aktivitetet e mëposhtme të biznesit:

- 1.16.1. Shërbime që mundësojnë vendosjen e parave të gatshme në një llogari pagese, si dhe të gjitha operacionet e nevojshme për operimin e një llogarie pagese;
 - 1.16.2. Shërbime që mundësojnë tërheqjen e parave të gatshme nga një llogari pagese, si dhe të gjitha operacionet e nevojshme për operimin e një llogarie pagese;
 - 1.16.3. Ekzekutimi i transaksioneve të pagesave, duke përfshirë transferimet e fondeve në një llogari pagese me ofruesin e shërbimit të pagesave të përdoruesit ose me një ofrues tjetër të shërbimit të pagesave.
 - 1.16.4. Ekzekutimi i transaksioneve të pagesave ku fondet mbulohen nga një linjë krediti për një përdorues të shërbimit të pagesave.
 - 1.16.5. Lëshimi i instrumenteve të pagesës dhe/ose marrja e transaksioneve të pagesave;
 - 1.16.6. Dërgesa parash;
 - 1.16.7. Shërbime inicimi pagesash;
 - 1.16.8. Shërbime informacioni për llogarinë.
- 1.17. Pjesëmarrës i drejtpërdrejtë (direkt)** – do të thotë një pjesëmarrës i drejtpërdrejtë në një sistem pagesash që si një palë udhëzon, bënë kliringun dhe shlyerjen e pagesave në emër të vet.
- 1.18. Pjesëmarrësi i drejtpërdrejtë-sponsor**- është një pjesëmarrës i drejtpërdrejtë i cili vepron si ndërmjetës dhe është përgjegjës për kliringun dhe shlyerjen e transaksioneve të pjesëmarrësve jo të drejtpërdrejtë në sistemin e pagesave, sipas një marrëveshje sponsorizimi.
- 1.19. Pjesëmarrës jo drejtpërdrejtë (indirekt)** – do të thotë pjesëmarrësit jo të drejtpërdrejtë që mbështeten të një pjesëmarrës i drejtpërdrejtë si në aspektin operacional ashtu edhe komercial për kliringun dhe shlyerjen e transaksioneve të pjesëmarrësve jo të drejtpërdrejtë.

Neni 3

Llojet e qasjes në sistemin e pagesave të operuar nga BQK dhe detyrimet e pjesëmarrësve

- 1. Sistemi i pagesave i BQK-së do të ofrojë dy lloje qasje për pjesëmarrje: pjesëmarrje të drejtpërdrejtë dhe pjesëmarrje jo të drejtpërdrejtë.
- 1.1. Pjesëmarrje e Drejtpërdrejtë
 - 1.1.1. Pjesëmarrësit e drejtpërdrejtë janë subjekte që i nënshtrohen rregullave dhe marrëveshjeve të sistemeve të pagesave të BQK-së, të cilat urdhërojnë, bëjnë kliringun dhe shlyerjen e pagesave në emër të tyre.
 - 1.1.2. Pjesëmarrësit e drejtpërdrejtë mund të veprojnë gjithashtu si ndërmjetës ose sponsorë për ofruesit e shërbimeve të pagesave jo-bankare (OSHP jo bankë) ose subjekte të tjera që nuk mund të marrin pjesë drejtpërdrejt ose zgjedhin të mos marrin pjesë.
 - 1.1.3. Për sistemet që shlyejnë pagesat në para të BQK-së, pjesëmarrësit e drejtpërdrejtë duhet të mbajnë një llogari shlyerjeje në BQK dhe të lidhen drejtpërdrejt me infrastrukturën

e saj, sistemin RTGS. Llogari të tilla mund të ofrojnë likuiditet dhe lehtësira brenda ditës për të siguruar sisteme efikase dhe të qëndrueshme të kliringut dhe shlyerjes.

1.1.4. Kategoritë e pjesëmarrësve të drejtpërdrejtë duhet të përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm në:

1.1.4.1. BQK-në;

1.1.4.2. Bankat Komerciale, të cilat mund të marrin mbështetje likuiditeti brenda ditës (ILF) nga BQK në bazë të kolateralit të vendosur;

1.1.4.3. Thesari/ Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve;

1.1.4.4. Fondet tjera publike të themeluara me Ligj, të cilët nuk shërbejnë nga bankat komerciale.

1.1.4.5. OSHP jo bankë, të cilat janë të pranueshme për pjesëmarrje të drejtpërdrejtë, por jo për mbështetje ditore të likuiditetit (ILF);

1.1.4.6. Operatorët e sistemeve të pagesave të licencuara nga BQK, si; ACH, sistemi TIPS Clone, si dhe sistemet tjera të pagesave.

1.2. Pjesëmarrja jo e drejtpërdrejtë

1.2.1. Pjesëmarrësit jo të drejtpërdrejtë janë subjektet, për transaksionet e të cilëve bëhet kliringun, shlyerja ose regjistrimi nga ose nëpërmjet një pjesëmarrësi të drejtpërdrejtë, pa qenë të detyruar drejtpërdrejt nga rregullat e sistemit të pagesave të BQK-së;

1.2.2. Pjesëmarrja jo e drejtpërdrejtë do të vendoset nëpërmjet një marrëveshjeje sponsorizimi me një pjesëmarrës të drejtpërdrejtë. Një kopje e marrëveshjes duhet t'i dorëzohet BQK-së për miratim;

1.2.3. Pjesëmarrësi i drejtpërdrejtë-sponsor do të mbetet plotësisht përgjegjës për shlyerjen e transaksioneve të paraqitura nga pjesëmarrësi jo i drejtpërdrejtë;

1.2.4. Pjesëmarrësit jo të drejtpërdrejtë mund të paraqesin transaksione:

1.2.4.1. nëpërmjet pjesëmarrësit të tyre të drejtpërdrejtë sponsor, ose

1.2.4.2. direkt në sistemin e BQK-së, në të cilin rast ata duhet të përmbushin standardet teknike dhe të mesazheve të sistemeve të pagesave.

1.2.5. BQK mund t'u kërkojë pjesëmarrësve të drejtpërdrejtë të mbajnë nën-llogari rezervë të veçanta për secilin pjesëmarrës jo të drejtpërdrejtë, në mënyrë që të sigurohet monitorimi dhe shlyerja efikase;

1.2.6. Pjesëmarrësit e drejtpërdrejtë do të përdorin instrumentin e mbështetjes ditore të likuiditetit (ILF) për shlyerjen e transaksioneve të tyre dhe të pjesëmarrësve të tyre jo të drejtpërdrejtë, në bazë të kolateralit të vendosur;

1.2.7. BQK mund të kufizojë numrin e pjesëmarrësve jo të drejtpërdrejtë për pjesëmarrësin e drejtpërdrejtë në mënyrë që të zbusë rreziqet e kreditit, likuiditetit dhe përqendrimit;

1.2.8. BQK rezervon të drejtën të kërkojë që një pjesëmarrës jo i drejtpërdrejtë të bëhet pjesëmarrës i drejtpërdrejtë kur vëllimi ose vlera e transaksioneve të tij e justifikon një pjesëmarrje të tillë.

1.3. Detyrimet e pjesëmarrësve të drejtpërdrejtë që veprojnë si sponsorë

- 1.3.1. Pjesëmarrësit e drejtpërdrejtë duhet të zbatojnë kritere transparente, të drejta dhe të bazuara në rrezik kur ofrojnë shërbime sponsorizimi për pjesëmarrësit jo të drejtpërdrejtë;
- 1.3.2. Pjesëmarrësit e drejtpërdrejtë duhet të ofrojnë informacion të mjaftueshëm mbi shërbimet e tyre, në mënyrë që pjesëmarrësit jo të drejtpërdrejtë të jenë në gjendje të bëjnë krahasime të qarta dhe të informuara;
- 1.3.3. Pjesëmarrësit e drejtpërdrejtë nuk duhet t'u kërkojnë pjesëmarrësve jo të drejtpërdrejtë të zbulojnë informacione të ndjeshme komerciale në lidhje me shërbimet e tyre të pagesave ose modelet e biznesit, përveç kur një gjë e tillë kërkohet në mënyrë të arsyetuar për përmbushjen e obligimeve ligjore, në përputhje me legjislacionin për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit (PPP/LFT);
- 1.3.4. Përfundimi i një marrëveshjeje sponsorizimi nga një pjesëmarrës i drejtpërdrejtë duhet të bëhet me njoftim paraprak të mjaftueshëm dhe t'i raportohet BQK-së;
- 1.3.5. Kur një pjesëmarrës jo i drejtpërdrejtë përfundon marrëveshjen e tij të sponsorizimit, ai duhet të njoftojë në mënyrë të rregullt pjesëmarrësin e tij të drejtpërdrejtë sponsor, si dhe BQK-në.

Neni 4

Qasja në sistemet e pagesave të operuara nga BQK

1. BQK, me kërkesë të OSHP-së jo-bankë do të aprovojë qasjen e drejtpërdrejt në sistemet e pagesave, nëse i njëjti ka përmbush kërkesat e mëposhtme:
 - 1.1. të jetë i autorizuar dhe i mbikëqyrur nga BQK për shërbimet përkatëse të pagesave;
 - 1.2. OSHP jo-bankë (ose një palë e tretë që kryen këto detyra, për veprimet dhe mosveprimet e së cilës OSHP-ja mbetet plotësisht përgjegjëse), instalon, menaxhon, operon, monitoron dhe siguron mbrojtjen e infrastrukturës përkatëse të TI-së që nevojitet për t'u lidhur me sistemet e pagesave, si dhe ka aftësinë të urdhëroj transferet e pagesave;
 - 1.3. Siguron çdo informacion mbështetës që BQK e konsideron të nevojshëm për të marrë një vendim lidhur me aplikimin për të përfutur qasje në sistemet e pagesave të operuar nga BQK;
 - 1.4. Zbaton masa të përshtatshme sigurie për të mbrojtur sistemet e saj nga qasja dhe përdorimi i paautorizuar, përfshirë aspektet që lidhen me qëndrueshmërinë kibernetike dhe sigurinë e informacioni;
 - 1.5. OSHP jo-bankë që aplikon për qasje në sistemet e pagesave, duhet të paraqesin në BQK një deklaratë të lëshuar nga organi kompetent i menaxhimit të OSHP jo-bankë, duke konfirmuar përputhshmërinë e OSHP jo-bankë me kushtet për të kërkuar pjesëmarrje, siç përcaktohen në nenin 5 të kësaj Rregulloreje.
2. BQK do të vlerësoj përputhshmërinë e OSHP-së jo bankë në pajtim me kërkesat e nenit 5 të kësaj Rregulloreje, sipas procedurave të përcaktuara në nenin 6.
3. Çdo OSHP jo-bankë që i është dhënë qasje në sistemet e pagesave për të operuar dhe mbikëqyrur nga BQK, duhet t'i paraqesë BQK-së një herë në çdo vit nga miratimi i qasjes në sistemet e pagesave, një deklaratë të nënshkruar nga organi i saj kompetent i menaxhimit, duke konfirmuar përputhshmërinë e vazhdueshme nga OSHP jo-bankë me kërkesat e përcaktuara në nën paragrafin 1.4 dhe 1.5 të këtij neni. BQK verifikon informacionin e dhënë në një deklaratë të tillë dhe mund të kërkojë çdo dokumentacion mbështetës që e konsideron të nevojshëm me qëllim verifikimi.

Neni 5

Kushtet për pjesëmarrje në sistemet e pagesave

1. OSHP-të jo-bankë që kërkojnë pjesëmarrje ose marrin pjesë në sistemet e përcaktuara sipas Ligjit për Sistemin e Pagesave, duhet të paraqesin në BQK:
 - 1.1. përshkrimin e masave të ndërmarra për mbrojtjen e fondeve të përdoruesve të shërbimeve të pagesave;
 - 1.2. përshkrimin e strukturës së qeverisjes dhe mekanizmave të kontrollit të brendshëm për shërbimet që synon të ofrojë, përfshirë procedurat administrative, kontabël dhe të menaxhimit të rrezikut, si dhe përshkrimin e përdorimit të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit në përputhje me Rregulloren për sistemet e informacionit dhe menaxhimin e rrezikut kibernetik dhe Rregulloren për teknologjinë e informacionit dhe komunikimit dhe menaxhimin e rrezikut të sigurisë;
 - 1.3. planin e likuidimit në rast dështimi.
2. Masat e mbrojtjes së fondeve të përdoruesve të shërbimeve të pagesave sipas nënparagrafit 1.1 të paragrafit 1 të këtij neni, duhet të përmbajnë:
 - 2.1. kur fondet mbrohen përmes depozitimit në llogari të veçantë në një bankë ose përmes investimit në asete të sigurta, likuide dhe me rrezik të ulët, përshkrimi duhet të përfshijë:
 - 2.1.1. politikën e investimit për të siguruar që asetet e investuara janë të sigurta, likuide dhe me rrezik të ulët;
 - 2.1.2. numrin dhe funksionet e personave me qasje në llogarinë e mbrojtjes;
 - 2.1.3. procesin e administrimit dhe rikonsilimit për të siguruar që fondet e përdoruesve të shërbimeve të pagesave janë të mbrojtura në interes të përdoruesve të shërbimeve të pagesave nga pretendimet e kreditorëve të tjerë të OSHP-së jo-bankë, veçanërisht në rast të falimentimit;
 - 2.1.4. kopjen e kontratës përkatëse me bankën;
 - 2.1.5. deklaratën e qartë për përputhshmëri me nenin 11 të Ligjit për Shërbimet e Pagesave.
 - 2.2. kur OSHP – jo-banka mbron fondet e përdoruesve të shërbimit të pagesave nëpërmjet një police sigurimi ose garancie të krahasueshme nga një kompani sigurimi ose një bankë, përshkrimi i masave të marra për një mbrojtje të tillë duhet të përmbajë sa vijon:
 - 2.2.1. konfirmimin se garancia apo polica e sigurimit nuk është lëshuar nga subjekt i së njëjtës grup me OSHP-në – jo-bankë;
 - 2.2.2. detajet e procesit të rekonsilimit për të siguruar që polica e sigurimit ose garancia e krahasueshme është e mjaftueshme për të përmbushur detyrimet e OSHP-së jo bankë;
 - 2.2.3. kohëzgjatjen dhe kushtet e rinovimit;
 - 2.2.4. kopjen e kontratës ose draftin e saj.
3. Masat e qeverisjes dhe kontrollit të brendshëm sipas nënparagrafit 1.2 të paragrafit 1 të këtij neni, duhet të jenë proporcionale, të përshtatshme, adekuate, dhe të përfshijnë:
 - 3.1. hartëzimin e rreziqeve të identifikuar nga OSHP- jo bankë, duke përfshirë llojet e rreziqeve dhe procedurat e duhura për të vlerësuar dhe parandaluar rreziqe të tilla;
 - 3.2. procedurat e ndryshme për të kryer kontrole periodike dhe të përhershme, përfshirë frekuencën e kontroleve dhe burimet njerëzore të alokuara;
 - 3.3. procedurat kontabël përmes të cilave OSHP-ja regjistron dhe raporton të dhënat financiare;

- 3.4. identitetin e personit ose personave përgjegjës për funksionet e kontrollit të brendshëm, përfshirë kontrollin periodik, të përhershëm dhe atë të përputhshmërisë, si dhe një CV të përditësuar të atij personi ose personave përgjegjës;
- 3.5. identitetin e auditorëve siç përcaktohet në aktet nënligjore të BQK-së;
- 3.6. përbërjen e organit drejtues dhe çdo organi mbikëqyrës;
- 3.7. një përshkrim të mënyrës se si funksionet e kontraktuara jashtë institucionit monitorohen dhe kontrollohen, në mënyrë që të shmanget dobësimi i cilësisë së kontrolleve të brendshme;
- 3.8. një përshkrim të mënyrës se si monitorohen dhe kontrollohen agjentët dhe degët brenda kuadrit të kontrolleve të brendshme;
- 3.9. përshkrimin e qeverisjes së grupit në rastet kur OSHP jo-bankë është filial i një subjekti të rregulluar jashtë vendit.
4. Plani i likuidimit sipas nënparagrafit 1.3 të paragrafit 1, të këtij neni duhet të përputhet me madhësinë dhe modelin e biznesit të OSHP-së jo-bankë dhe të përmbajë masat lehtësuese për ndërprerjen e shërbimeve, duke garantuar ekzekutimin e transaksioneve të pezulluara dhe përfundimin e kontratave ekzistuese.

Neni 6

Procedura e Aplikimit

1. OSHP-të jo Banka që shprehin interesim për qasje direkte në sistemet e pagesave, duhet të aplikojnë me shkrim në BQK. Aplikacioni duhet të përmbajë informacionin e mëposhtëm:
 - 1.1. Kërkesën për pjesëmarrje në sistemin e pagesave ndërbankare – KIPS (shtojca 1)
 - 1.2. Dëshmi të autorizimit nga BQK, si ofrues i shërbimeve të pagesave;
 - 1.3. Deklaratë mbi kapacitetin operacional;
 - 1.4. Politikat e menaxhimit të rrezikut;
 - 1.5. Masat për siguri TI dhe vazhdimësi të biznesit;
 - 1.6. Dëshmi lidhur me përmbushjen e kushteve të përcaktuara nga neni 5 i kësaj Rregulloreje.
2. Gjatë procesit të vlerësimit të aplikacionit, sipas nevojë, BQK mund kërkoj dokumente shtese të nevojshme për vlerësim, si dhe të inicioj vizita-inspektime në vend, në funksion të verifikimit të plotësimit të kriterëve për pjesëmarrje.
3. BQK bazuar në vlerësimin e aplikacionit sipas kërkesave të parapara në këtë nen, brenda afatit prej 45 ditëve nga pranimi i aplikacionit të kompletuar, aprovon apo refuzon qasjen duke dhënë arsyetimet përkatëse.

Neni 7

Procedura për qasjen e institucioneve të reja në sistemin ndërbankar të pagesave – KIPS

1. BQK përcakton procedurat dhe kriteret për përfshirjen e institucioneve jo-banka të autorizuar në sistemin ndërbankar të pagesave të BQK-së (KIPS), duke siguruar përputhshmëri me kërkesat teknike, operationale dhe rregullatore.
2. Për qasjen në sistemet e ndërlidhura, OSHP-të jo banka duhet të jenë paraprakisht pjesëmarrës në KIPS, nga ku duhet ti plotësojnë rregullat teknike për qasje në ato sisteme.

3. Procesi i qasjes së një institucioni të ri në KIPS është i ndarë në katër faza të detyrueshme dhe të njëpasnjëshme, si vijon:

3.1. Faza I – Edukimi dhe shkëmbimi fillestar i informacionit

- 3.1.1. Institucioni i interesuar njofton me shkrim BQK-në për synimin e tij për t'u bërë pjesëmarrës i drejtpërdrejtë në KIPS;
- 3.1.2. BQK i kthen përgjigje zyrtare institucionit, duke i vënë në dispozicion informacion për strukturën, funksionalitetin dhe rregullat e sistemit KIPS, si dhe kërkesat teknike dhe operacionale për pjesëmarrje;
- 3.1.3. BQK organizon një takim informues me menaxhmentin e lartë të institucionit aplikues, me qëllim sqarimin e çdo paqartësie apo çështjeje të hapur në lidhje me kërkesat për pjesëmarrje.

3.2. Faza II – Zotimi dhe Aplikimi Formal

- 3.2.1. Institucioni aplikues paraqet një kërkesë zyrtare në DSP pranë BQK-së për pjesëmarrje në KIPS (shtojca 1), të nënshkruar nga organi drejtues kompetent;
- 3.2.2. Kërkesa duhet të shoqërohet me dokumentacionin përkatës sipas nenit 6 të kësaj Rregullore.

3.3. Faza III – Vlerësimi i Rrezikut dhe Përshtatshmërisë për qasje

- 3.3.1. BQK kryen një proces të detajuar të vlerësimit të rrezikut për institucionin aplikues, përmes sektorëve të saj përkatëse.
- 3.3.2. Vlerësimi bazohet në:
 - 3.3.2.1. Informacionin dhe dokumentacionin e dorëzuar nga institucioni;
 - 3.3.2.2. Burime zyrtare dhe të besueshme të disponueshme për BQK-në;
- 3.3.3. BQK vlerëson nivelin e ekspozimit ndaj rrezikut dhe përcakton përshtatshmërinë e institucionit bazuar në informacionet e kërkuara sipas nenit 6 të kësaj Rregulloreje, si dhe duke aplikuar metodologjitë e standardizuara të vlerësimit të rrezikut që do t'i zhvillojë në të ardhmen.
- 3.3.4. Bazuar në rezultatet e vlerësimit të rrezikut dhe përshtatshmërisë me kriteret e mësipërme, përcaktohet nëse institucionit i jepet e drejta për qasje në KIPS.
- 3.3.5. Në varësi të nivelit të rrezikut të identifikuar, përcaktohet edhe frekuenca e rishikimit dhe monitorimit të institucionit.

3.4. Faza IV – Implementimi Teknik dhe Operacional

- 3.4.1. Pas miratimit të aplikimit nga BQK, institucioni kalon në fazën e implementimit teknik dhe operacional, për të realizuar integrimin e plotë me sistemin KIPS.
- 3.4.2. BQK cakton një afat maksimal prej 3 (tre) muajsh për përfundimin me sukses të kësaj faze, që përfshin:
 - 3.4.2.1. Testimin e plotë të lidhjes teknologjike me KIPS, përputhshmërinë me standardet e komunikimit (p.sh. përdorimi i mesazheve ISO 20022), si dhe sigurinë e sistemeve dhe pajisjeve të institucionit; realizimin e testeve

funkzionale, testimeve të ngarkesës dhe skenarëve të rikuperimit nga fatkeqësitë;

3.4.2.2. Nënshkrimin e marrëveshjes/letërpëlqimit (shtojca 2) për pjesëmarrje në KIPS;

3.4.2.3. Trajnimin e stafit përgjegjës për operimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve në përputhje me kërkesat e BQK-së.

3.4.3. Nëse institucioni dështon të përfundojë me sukses fazën e implementimit brenda afatit të përcaktuar për një periudhë 3 (tre) mujore, ai pezullohet automatikisht nga procesi. Pas kësaj periudhe, institucioni mund të paraqesë sërish kërkesë për rifillimin e procedurës.

4. Institucioni fillon të operojë si pjesëmarrës i drejtpërdrejt në KIPS, vetëm pas njoftimit zyrtar të BQK-së për aktivizim operacional.

Neni 8

Qasja në sistemet e ndërlidhura

Pjesëmarrja e një OSHP jo-bankë në sistemet e ndërlidhura, kërkon që subjekti të jetë pjesëmarrës në sistemin e KIPS-it si dhe të përshtatet me kushtet specifike të vetë sistemit përkatës. Këto kushte përfshijnë kërkesa teknike, operationale dhe rregullatore, të cilat mund të ndryshojnë varësisht nga natyra dhe funksionaliteti i sistemit. Si e tillë, pjesëmarrja në këto sisteme nuk është automatike, por varet nga një vlerësim i detajuar i përshtatshmërisë dhe përputhshmërisë me rregullat dhe standardet e sistemit përkatës.

Neni 9

Detyrimet e pjesëmarrjes në sistemet e pagesave dhe kufizimet në qasje

1. OSHP-të jo-banka me qasje të autorizuar do të jenë të detyruar:
 - 1.1. Të zbatojnë dhe respektojnë rregullat e sistemeve të pagesave;
 - 1.2. Të mbajnë masa adekuate për integritetin dhe sigurinë e transaksioneve, si dhe qasjeve të përdoruesve brenda institucioneve përkatëse;
 - 1.3. Të dorëzojnë raporte periodike sipas kërkesave të BQK-së;
 - 1.4. Të lejojnë aktivitetet mbikëqyrëse të BQK-së sipas rastit;
 - 1.5. Të qasen në sisteme të pagesave në çdo kohë gjatë ditës së operimit, duke respektuar oraret punës së sistemeve;
 - 1.6. Të lejojë vetëm personelin e autorizuar të operojë në sisteme të pagesave;
 - 1.7. Të hartojnë procedura të brendshme për sigurinë dhe mbrojtjen e sistemit, duke përfshirë procedurat organizative (burimet njerëzore dhe pajisjet kompjuterike), në përputhje me kornizën ligjore të BQK;
 - 1.8. Të raportojnë menjëherë në BQK për parregullsi të vërejtura apo të dyshuara të sigurisë e sistemeve të pagesave;

- 1.9. Të ruajnë regjistrimet e transaksioneve të pagesave në kopje letër dhe/ose në formë elektronike varësisht nga forma si janë iniciuar transaksionet e pagesave për një periudhë jo më pak se pesë (5) vite, sipas standardeve dhe rregullave kontabël në fuqi;
- 1.10. Të hartojnë një plan reagimi ndaj emergjencave, që siguron ekzekutimin në kohë të operacioneve të përditshme në rrethana të paparashikuara.
2. BQK mund të kufizojë përkohësisht pjesëmarrësin në sistemet e pagesave kur pjesëmarrësi nuk është në gjendje të ekzekutojë kërkesat për shlyerje. Gjatë këtij kufizimi, pjesëmarrësi ka qasje në sistem, por nuk mund të kryejë pagesa me pjesëmarrësit e tjerë. Kufizimi hiqet kur sigurohen fondet e nevojshme në llogarinë e tij të shlyerjes, dhe BQK njofton menjëherë pjesëmarrësit përmes kanaleve zyrtare.
3. BQK mund të pezullojë qasjen e një pjesëmarrësi në sistemet e pagesave në rastet kur pjesëmarrësi nuk siguron fondet e nevojshme për shlyerje, rrezikon stabilitetin financiar ose shkel kërkesat e rregullores. Pezullimi njoftohet me shkresë zyrtare dhe përfshin ngrirjen e menjëhershme të llogarive të tij. BQK nuk mban përgjegjësi për humbje të mundshme dhe pezullimi hiqet kur përmbushen kushtet përkatëse.
4. BQK mund të përjashtojë një pjesëmarrës nga sistemet e pagesave në raste si:
 - 4.1. me anë të kërkesës me shkrim nga vetë pjesëmarrësi;
 - 4.2. bashkimi me pjesëmarrësin tjetër;
 - 4.3. mosplotësimi i fondeve pas pezullimit;
 - 4.4. mosrespektimi i akteve nënligjore të sistemeve;
 - 4.5. vendosja në likuidim dhe revokimi i licencës, apo mosshfrytëzimi i sistemeve për 12 muaj.
5. Vendimi për përjashtim i komunikohet pjesëmarrësit dhe BQK mbyll llogarinë e tij në RTGS.

Neni 10

Llogaritë në sistemet e pagesave të operuara nga BQK dhe mos ofrimi i llogarive për mbrojtje të fondeve

1. Për qëllime të shlyerjes së urdhërpagesave, OSHP-ve jo-banka do ju lejohet hapja e një llogarie të shlyerjes në modulën e RTGS-së në sistemin e KIPS-it, përmes së cilës realizohet shlyerja e pagesave nga të gjitha sistemet tjera të ndërlidhura.
2. Llogaria e mbajtur nga OSHP jo-bankë në RTGS do të përdoret vetëm për shlyerjen e urdhërpagesave. Gjithashtu, nga kjo llogari do të sigurohet likuiditeti për shlyerjen e pagesave në sistemet e ndërlidhura (sistemet e pagesave me vlera të vogla, si; ACH, TIPS clone, etj.), sisteme në të cilat pjesëmarrësit mund të qasen vetëm nëse plotësojnë kriteret specifike të përcaktuara me rregulloret përkatëse të tyre, si dhe në të cilat pjesëmarrësit duhet të hapin nën-llogari.
3. Bazuar në Ligjin për BQK, në funksion të menaxhimit të likuiditetit, BQK ofron mbështetje me hua brenda ditore apo njëditore vetëm për bankat, por jo edhe për OSHP-të jo-banka.
4. Për qëllimet të këtij neni llogaritë që ofrohen për qëllime të shlyerjes të urdhërpagesave në sistemet e pagesave nuk do të konsiderohen si llogari për mbrojtjen e fondeve.
5. Kompensimi për fondet e mbajtura në llogaritë e OSHP-ve jo-banka në sistemet e pagesave të operuara nga BQK do të jetë në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 11

Shumat maksimale të mbajtura në llogari nga OSHP-të jo-bankë

1. Shumat e fondeve që mbahen në fund të ditës së punës nga një OSHP jo-bankë, në të gjitha llogaritë në sistemet e pagesave, nuk duhet të kalojnë shumën maksimale të mbajtjes që aplikohet për sistemet e pagesave.
2. Shuma maksimale e mbajtjes nga një OSHP jo-bankë, përcaktohet për të siguruar që kjo llogari do të përdoret vetëm për qëllime të shlyerjes së pagesave dhe jo si depozita. Kjo masë ndihmon;
 - 2.1. në parandalimin e devijimit të fondeve nga sektori bankar;
 - 2.2. parandalimin e skenarëve ku OSHP-të jo-bankë përfitojnë nga përfitimet e mbajtjes së fondeve në BQK pa qenë subjekt i të njëjtave kërkesa rregullatorë si bankat (si p.sh. kapitali rregullator, rezervat minimale apo kërkesat për likuiditet); si dhe,
 - 2.3. ruajtjen e konkurrencës së drejtë ndërmjet bankave dhe institucioneve jo-bankare.
3. Fondet e përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni, përfshijnë fondet që mbahen në fund të ditës së punës nga OSHP-të jo-banka në llogarinë e mëposhtme në sistemet e pagesave të BQK-së, përfshirë:
 - 3.1. Llogarinë e shlyerjes e cila përdoret për mbajtjen e fondeve për shlyerjen e pagesave ndërmjet pjesëmarrësve në sistem;
 - 3.2. Nën-llogaritë në sistemet e ndërlidhura, (sistemet e pagesave me vlera të vogla (ACH, TIPS clone, etj.).
4. Shuma maksimale e mbajtjes, e përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni, do të llogaritet si vijon:
 - 4.1. Në rastet kur OSHP jo-bankë ka qenë duke operuar për një periudhë prej 12 muajsh para aplikimit për qasje në një sistem pagese të operuar nga BQK, shuma maksimale e lejuar për mbajtje, do të jetë sa dyfishi i vlerës më të lartë të urdhër transferave dalës, përfshirë – kur është e zbatueshme – edhe urdhër transferet dalës nga sistemet ndihmëse, por duke përjashtuar transferet e likuiditetit dhe fondet vetanake OSHP-së jo-bankë, në cilëndo ditë pune gjatë periudhës së mëparshme 12-mujore kalendarike. OSHP-ja jo-bankë duhet ta përfshijë përllogaritjen e detajuar të kësaj shume maksimale në aplikacionin e saj drejtuar BQK-së për pjesëmarrje në sistemin e pagesave.
 - 4.2. Në rast se OSHP-ja jo-bankë nuk ka qenë në operim për një periudhë prej 12 muajsh para aplikimit për qasje në sistemet e pagesave të operuar nga BQK, shuma maksimale e mbajtjes do të jetë dyfishi i vlerës së parashikuar totale maksimale të urdhër transferave dalës nga OSHP-ja jo-bankë duke përfshirë, kur është e nevojshme, edhe urdhrat për transferat nga sistemet e ndërlidhura, por duke përjashtuar transferat e likuiditetit dhe fondet vetanake. OSHP-ja jo-bankë duhet të përfshijë llogaritjen e detajuar të shumës së propozuar maksimale të mbajtjes në aplikimin e saj për pjesëmarrje në sistemet e pagesave të operuar nga BQK.
 - 4.3. Gjatë periudhës 12-mujore pas hapjes së llogarisë së parë aktive në sistemet e pagesave të operuar nga Banka Qendrore, BQK do të ri-llogarisë shumën maksimale të mbajtjes për secilën OSHP jo-bankë çdo muaj gjatë tremujorit të parë, dhe më pas çdo tremujor. Shuma e ri-llogaritur maksimale e mbajtjes do të zbatohet nga dita e parë e punës pas njoftimit të OSHP-së jo-bankë nga BQK dhe do të mbetet në fuqi deri në ri-llogaritjen pasuese.

- 4.4. Pas përfundimit të periudhës së parë 12-mujore nga hapja e llogarisë së parë aktive në sistemet e pagesave, BQK do të ri-llogarisë shumën maksimale të mbajtjes një herë në vit. Ri-llogaritja do të bazohet në vlerën totale maksimale të urdhër transferave dalës të OSHP-së jo-bankë, duke përfshirë, kur është e nevojshme, edhe urdhrat e transferave nga sistemet e ndërlidhura, por duke përjashtuar transferat e likuiditetit dhe fondet vetanake, gjatë periudhës 12-mujore paraprake në sistemet e pagesave të operuar nga BQK. Gjithashtu, ri-llogaritja do të mbështetet në informacionin e ofruar nga OSHP-ja jo-bankë në përputhje me nën paragrafët 4.1 dhe 4.2 të këtij neni.
- 4.5. Në rrethana të jashtëzakonshme, Banka Qendrore, sipas vlerësimit të saj, mund të ri-llogarisë shumën maksimale të mbajtjes në mënyrë të jashtëzakonshme (ad-hoc), në rast të një ndryshimi të rëndësishëm — të afërt ose tashmë të ndodhur — në vlerat e shlyerjes së një OSHP jo-bankë i cili mund të çojë në mospërputhje me shumën përkatëse maksimale të mbajtjes. Çdo ri-llogaritje e tillë do të bëhet në përputhje me nën paragrafin 4.2 të këtij Neni.
5. Në rast se totali i fondeve në llogaritë e OSHP-së jo bankë tejkalon shumën maksimale të lejuar të mbajtjes, OSHP-ja jo-bankë duhet të ndërmarrë menjëherë veprime për të reduktuar shumën totale të fondeve në një nivel nën kufirin maksimal të mbajtjes. Nëse një reduktim i tillë nuk është i mundur për shkak të një pagese hyrëse pak para përfundimit të ditës së punës, atëherë reduktimi duhet të bëhet pa vonesa të panevojshme pas fillimit të ditës së ardhshme të punës.
6. BQK do të rishikojë sipas nevojës llojet e llogarive të listuara në paragrafin 3 të këtij neni, jo më vonë se një vit pas datës kur kjo Rregullore hyn në fuqi, dhe më pas të paktën çdo tre vjet. BQK gjithashtu do të rishikojë metodën për llogaritjen e shumës totale maksimale të mbajtjes, siç përcaktohet në paragrafin 4 të këtij neni, jo më vonë se një vit pas datës kur kjo Rregullore hyn në fuqi, dhe më pas të paktën çdo tre vjet.

Neni 12

Mos-përputhja me kufirin e shumës totale maksimale të mbajtjes ose me kërkesat për qasje në sistemet e pagesave të operuara dhe mbikëqyrura nga BQK

1. Në rast se një OSHP jo-bankë nuk i përmbahet kërkesave të nenit 11 të kësaj Rregullore, BQK do të vendosë një gjobë prej 0.03% mbi shumën totale që tejkalon shumën maksimale të mbajtjes në llogari që OSHP-ja jo-bankë mban në fund të ditës së punës në sistemin e pagesave, si dhe një gjobë shtesë ditore prej 1,000.00 EUR për çdo ditë mos-përputhjeje.
2. Në rast se OSHP-ja nuk korrigjon një mos-përputhje të rëndësishme me kërkesat e nenit 11 të kësaj rregulloreje, BQK mund të ndërpresë pjesëmarrjen e OSHP-së jo-bankë në sistemin e pagesave me një njoftim paraprak prej një muaji dhe do të vendosë një gjobë shtesë një herë prej 1,000.00 EUR për çdo llogari të mbyllur. Për qëllimet e këtij paragrafi, çdo rast i përcaktuar sipas nën paragrafit 2.1 dhe 2.2, të këtij paragrafi do të konsiderohet, përveç të tjerave, si një rast i mos-përputhjes së rëndësishme:
 - 2.1. shkelje sistematike ose e përsëritur e kufirit për shumën totale maksimale të mbajtjes së fondeve, përfshirë por pa u kufizuar vetëm në shkelje që përfshin një shumë të konsiderueshme mbi kufirin përkatës të shumës totale maksimale të mbajtjes;
 - 2.2. dështimi për të reduktuar shumën e mbajtur në llogaritë përkatëse në nivel nën shumën totale maksimale të mbajtjes deri në fund të ditës së punës pas ditës së punës kur fondet janë pranuar.

3. Nëse një OSHP jo-bankë nuk i përmbahet kërkesave të përcaktuara në paragrafin 1 të nenit 4 të kësaj Rregullore, BQK mund të ndërpresë pjesëmarrjen e OSHP-së jo-bankë në sistemin e pagesave pa njoftim paraprak.
4. Në rast se një OSHP jo-bankë nuk i përmbahet kërkesave të përcaktuara në paragrafin 3 të nenit 4, të kësaj Rregullore, BQK mund të ndërpresë pjesëmarrjen e OSHP-ve jo-bankë në sistemin e pagesave me një njoftim paraprak prej një muaji.

Neni 13

Mbikëqyrja dhe Zbatimi

1. BQK do të mbikëqyrë në mënyrë aktive aktivitetet e OSHP jo-bankë për të siguruar përputhshmëri të plotë me dispozitat e kësaj Rregullore. Kjo përfshin monitorimin e vazhdueshëm të praktikave operative, respektimin e kërkesave teknike dhe të sigurisë, si dhe përputhshmërinë me çdo detyrim raportimi të përcaktuar nga BQK.
2. Në rast mospërputhjeje, BQK rezervon të drejtën për të marrë masa dhe ndëshkime përkatëse administrative sipas nenit 17 të kësaj rregulloreje. Këto masa do të merren në mënyrë proporcionale dhe në përputhje me natyrën e shkeljes, veçanërisht kur një mospërputhje e tillë përbën rrezik për sigurinë, efikasitetin ose integritetin e sistemit të pagesave.
3. Veprimet zbatuese do të kryhen në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, dhe OSHP-ve jo-bankë do t'u jepet mundësia për t'iu përgjigjur gjetjeve të BQK-së përpara se të shqiptohen masa dhe ndëshkimet administrative, përveç rasteve kur është e nevojshme të merren masa të menjëhershme për të mbrojtur sistemin ose pjesëmarrësit e tij.

Neni 14

Tarifat

Tarifat të cilat aplikohen ndaj OSHP-ve jo banka për pjesëmarrje në sistemin e pagesave të BQK-së, përcaktohen nga BQK.

Neni 15

Rishikimi dhe Përditësimi

Kjo Rregullore i nënshtrohet rishikimit periodik të paktën një herë në tre vjet, për të siguruar rëndësinë, efektivitetin dhe përputhshmërinë e tij të vazhdueshme me kërkesat rregullatorë në zhvillim. Përveç rishikimeve të planifikuara, Rregullorja mund të përditësohet ose rishikohet sa herë që është e nevojshme në pajtim me ndryshimet e legjislacionit në fuqi, zhvillimeve rregullatorë, standardeve ndërkombëtare ose praktikave më të mira në zhvillim në këtë fushë.

Neni 16

Shtojcat

1. Pjesë përbërëse e kësaj Rregulloreje janë Shtojcat:
 - 1.1. Shtojca 1 - Kërkesë për pjesëmarrje në Sistemin e Pagesave Ndërbankare – KIPS;

1.2. Shtojca 2 - Letërpëlqim për pjesëmarrje në Sistemin e Pagesave Ndër-bankare – KIPS.

Neni 17

Zbatimi, masat përmirësuese dhe ndëshkime

Përveç masave të përcaktuara në nenin 12 të kësaj rregulloreje ndërlidhur me nenin 4 dhe 11, çdo shkelje e dispozitave të tjera të kësaj Rregulloreje do të jetë subjekt i masave përmirësuese dhe/apo ndëshkimeve administrative civile, të përcaktuara në Ligjin Nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, Ligjin Nr. 04/L-155 për Sistemet e Pagesave si dhe Ligjit Nr. 10/L-026 për Shërbimet e Pagesave.

Neni 18

Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi 15 ditë nga data e miratimit të saj.

Dr.sc. Bashkim Nurboja

Kryetar i Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës

Shtojca 1



KËRKESË PËR PJESËMARRJE NË SISTEMIN E PAGESAVE NDËRBANKARE – KIPS

Në emër të [Institucionit Aplikues], me anë të kësaj kërkesë deklaroj qëllimin e institucionit tonë për t'u bërë pjesëmarrës i drejtpërdrejtë në Sistemin e Pagesave Ndërbankare të operuar nga Banka Qendrore e Kosovës (BQK).

[Institucioni aplikues] e pranon se politika për menaxhimin e llogarive dhe shërbimet e pagesave e BQK-së parashikon kërkesat teknike dhe procedurale për sa i përket krijimit të pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë. Ne pranojmë se përmbushja e këtyre kërkesave kërkon përfshirjen aktive të njësive përkatëse organizative brenda institucionit tonë për të siguruar përputhjen me pritjet e BQK-së.

Gjatë gjithë procesit të përfshirjes, [Institucioni Aplikues] është i përkushtuar për të nxitur bashkëpunim efektiv dhe shkëmbim informacioni në kohë me BQK-në.

Të dyja palët pranojnë se kjo deklaratë shërben vetëm si një shprehje interesi nga [Institucioni Aplikues] për të ndjekur pjesëmarrjen e drejtpërdrejtë. Ajo nuk përbën një angazhim ligjërisht të detyrueshëm as për [Institucionin Aplikues] as për Bankën Qendrore të Kosovës.

Nënshkrimi nga pjesëmarrësi:

Emri i plotë i drejtorit:	Nënshkrimi:	Data:
---------------------------	-------------	-------

Shtojca 2



LETËRPËLQIM PËR PJESËMARRJE NË SISTEMIN E PAGESAVE NDËRBANKARE – KIPS

Me këtë Letërpëlqim pjesëmarrësi pajtohet me kriteret si në vijim:

1. Pjesëmarrësi do t'i respektojë dhe do të zbatojë rregulloren e sistemit të KIPS-it dhe udhëzimet operacionale përkatëse;
2. Pjesëmarrësi konfirmon pranimin e kopjes së Rregullores të KIPS-it dhe Rregullores për qasjen e ofruesëve të shërbimeve të pagesave jo-banka në sistemet e pagesave dhe se është i njoftuar me udhëzimet për përdorim të KIPS-it;
3. Pjesëmarrësi zotohet të mos ndikojë negativisht në efikasitetin e KIPS-it dhe në integritetin e transaksioneve të pagesave të dërguara dhe pranuar, shlyerjen e atyre transaksioneve apo të rrezikoj sistemin KIPS;
4. Pjesëmarrësi merr përsipër të paguajë tarifat dhe pagesat e tjera të detyrueshme të caktuara në kuadër të rregullativës përkatëse të BQK-së;
5. Të drejtat dhe detyrimet e parapara në këtë letërpëlqim nuk janë vetëm për sistemin KIPS, por vlejnë edhe për të gjithë pjesëmarrësit e tjerë që janë pajtuar t'i respektojnë dhe të zbatojnë rregulloren e KIPS-it, marrëveshjet dhe udhëzimet përkatëse;
6. Pjesëmarrësi me këtë dokument e autorizon BQK-në të administron me llogaritë e tij të mbajtur në KIPS me qëllim të funksionimit të duhur të këtij sistemi;
7. Për përdorim të sistemit të KIPS-it pjesëmarrësit duhet të plotësojnë formularin si në vijim:

Për:	Departamentin e Sistemit të Pagesave Banka Qendrore të Republikës së Kosovës	
Nga:	Emri i aplikuesit:	
	Vendi:	
	Numri i biznesit:	
	Adresa e zyrës qendrore:	
	SWIFT BIC:	
	Llogaria për shlyerje:	
	Kontakt personi për operacione në sisteme të pagesave:	
	Numri i telefonit:	
	Numri i faksit:	
	E-mail:	
	Kontakt personi për shërbime të TI-së	
	Numri i telefonit:	
	Numri i faksit:	
	E-mail:	
	Data e preferuar e fillimit: (Kjo është data e preferuar nga kur aplikuesi dëshiron të filloj përdorimin e KIPS-it.)	

Nënshkrimi nga pjesëmarrësi:

Emri i plotë i drejtorit:	Nënshkrimi:	Data: